

SEKSIONI I DYTË VENDIM

Kërkesa nr. 62907/16

Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Komision, më 5 mars 2019, i përbërë nga:

Valeriu Grițco, *kryetar*,

Ivana Jelić,

Darian Pavli, *gjyqtarë*,

dhe Hasan Bakırcı, *zëvendëssekretar i Seksionit*,

në lidhje me kërkesën e mësipërme, paraqitur më 25 tetor 2016,

në lidhje me deklaratat formale, ku pranohej një zgjidhje me pajtim e çështjes,

pasi diskutoi, vendosi si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Një listë me kërkesit paraqitet në shtojcë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agentja e saj e atëhershme, znj. A. Hicka, nga Avokatura e Shtetit.

Kërkuesit u ankuan, mbështetur në nenin 2 të Konventës, se e drejta për jetën e familjarëve ishte shkelur si pasojë e veprimeve të Gardës Kombëtare gjatë protestës së zhvilluar më 21 janar 2011. Gjithashtu, ata u ankuan se përdorimi i dhunës vdekjeprurëse nuk ishte absolutisht e nevojshme dhe se autoritetet, nuk kryen një hetim efikas për vdekjen e familjarëve të tyre.

Kërkesa iu komunikua Qeverisë më 20 nëntor 2017.

Më 30 korrik 2018 dhe më 14 dhjetor 2018, Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore, të firmosura nga të gjitha palët.

Deklarata parashtron si më poshtë:

“Kërkuesit ranë dakord të heqin dorë nga pretendime të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet, të cilat ngrenë këtë kërkesë kundër angazhimit të Qeverisë për t’i paguar ata:

Rinaldo Myrtaj, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Mamude Myrtaj, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Ilmi Deada, EUR 15,600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro)

Alma Rredhi, EUR 10,000 (dhjetë mijë euro).

për të mbuluar dëmet monetare dhe jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të jenë në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës së lartpërmendur prej tre muajsh, Qeveria merr përsipër të paguajë interes të thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës përkatëse plus tre përqind. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Në vijim, Qeveria pranon se hetimi i kryer për rrethanat e vdekjes së të afërmeve të kërkuesve nuk pajtohej me nenin 2 të Konventës dhe se këto çështje nuk adresoheshin në procedimet penale të realizuara, të sipërpërmendura.

Gjithashtu, Qeveria ndërmerr rihapjen e procedimeve të brendshme penale për këtë çështje, duke marrë në konsideratë përfshirjen e të afërmeve të viktimave në këto procedime.”

LIGJI

Gjykata përqendrohet në zgjidhjen me pajtim të arritur midis palëve. Ajo sigurohet se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos, ta heq kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 28 mars 2019.

Hasan Bakırcı
ZËVENDËSSEKRETAR

Valeriu Griçco
KRYETAR

SHTOJCË

Nr.	Emri/MBIEMRI	Viti i lindjes	Kombësia	Vendbanimi	Përfaqësues
1	Rinaldo MYRTAJ	1986	shqiptare	Fier	D. Matlija
2	Ilmi DEDA	1976	shqiptare	Tiranë	D. Matlija
3	Zabit DEDA ^{*1}	1970	shqiptare	Tiranë	D. Matlija
4	Mamude MYRTAJ	1963	shqiptare	Fier	D. Matlija
5	Alma RREDHI	1975	shqiptare	Fier	D. Matlija
6	Ana VEIZI*	1999	shqiptare	Fier	D. Matlija
7	Klasjdi VEIZI*	1996	shqiptare	Fier	D. Matlija

¹ Ankesat në lidhje me kërkesat e specifikuar me një asterisk u kundërshtuan si të papranueshme duke qenë se në thelb ishin të njëjtat me ato në kërkesën nr. 16191/13.